



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 6, datë 12.1.2024

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS
PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE TË ZYRTARËVE
DHE TË TË ZGJEDHURVE VENDORË**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve dhe të të zgjedhurve vendorë (në vijim grupi ndërinstitucional i punës).
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe të ketë në përbërje këta anëtarë:
 - Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike;
 - Drejtorin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
 - Drejtorin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike;
 - Drejtorin e Drejtorisë së Financave Vendore, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

- Drejtorin e Përgjithshëm të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë.

3. Grupi ndërinstitucional i punës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Analizon kuadrin ligjor në fuqi e dokumentet strategjike si dhe raportet e institucioneve publike e programet e asistencës teknike për NJVV-të.
 - b) Propozon nisma ligjore e nënligjore, planin e veprimit dhe masa të tjera të nevojshme për ngritjen e institucioneve përgjegjëse për zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve dhe të të zgjedhurve vendorë.
 - c) Përgatit propozime për t'i paraqitur në mbledhjen e Këshillit Konsultativ Qeverisje Qendrore-Vetëqeverisje Vendore dhe në takimin e grupit tematik të donatorëve për decentralizimin, sipas rastit, në lidhje me zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve dhe të të zgjedhurve vendorë.
 - ç) Kryen çdo detyrë tjetër që caktohet nga kryetari i grupit ndërinstitucional i punës, në funksion të detyrave e të përgjegjësive të parashikuara në këtë urdhër.
4. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore të kryejë rolin e sekretariatit teknik, në mbështetje të veprimtarisë së grupit ndërinstitucional të punës.
5. Grupi ndërinstitucional i punës të mblidhet, si rregull, 1 (një) herë në 2 (dy) muaj dhe sa herë konsiderohet e nevojshme nga kryetari.
6. Në takimet e grupit ndërinstitucional të punës ftohen të marrin pjesë përfaqësuesit e shoqatave të vetëqeverisjes vendore: Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV), Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë (SHKQSH) si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera publike, grupe interesi, përfaqësues apo ekspertë të donatorëve e të organizatave ndërkombëtare, si dhe ekspertë të fushës.
7. Titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2 të caktojnë përfaqësuesin e tyre dhe të njoftojnë me shkresë zyrtare ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
8. Grupi ndërinstitucional i punës të zhvillojë mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
9. Afati i veprimtarisë së grupit ndërinstitucional të punës të fillojë nga miratimi i urdhrit dhe të përfundojë në datën 31 dhjetor 2024.

10. Ngarkohen grupi ndërinstitutional i punës dhe sekretariati teknik për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

A large, stylized handwritten signature in black ink is written over the printed name 'EDI RAMA' and extends upwards and to the left, crossing the word 'KRYEMINISTRI'.

NR.PROT.5493/7
DATË 12.1.2024

MINISTRIT TË SHËTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË DREJTËSISË
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
AGJENCISË PËR MBËSHËTETJEN E VETËQEVERISJES
VENDORE
SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI



Engjëll Agaçi